

NJOFTIM MBI AUDITIMIN PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME PËR 3-MUJORIN E IV TË VITIT 2015 DHE 9-MUJORIN E VITIT 2016” NË 22 SUBJEKTE¹

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2015 dhe 2016, sipas programit të auditimit nr.1115, datë 04.11.2016 si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr.1, datë 04.11.2016 “*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të kontrollit të lartë të shtetit*”, rezultoi se në 22 subjekte të audituar, janë rekomanduar gjithsej 447 masa, nga të cilat janë pranuar 417 masa ose 93.3% e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar 30 masa pra 6.7%. Konstatuam se nga 416 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 187 prej tyre ose 44,8 %, pjesërisht 19 masa ose 4.6 %, dhe konsiderohen në proces zbatimi 174 masa ose 42 %. Nga auditimi rezultuan 36 masa të pazbatuara të cilat përfaqësojnë 8,6 % të masave të propozuara.

Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

- 1. Masa për përmirësime ligjore** janë rekomanduar **26**, nga të cilat janë pranuar po **26** masa. Rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar **10** rekomandime, janë zbatuar pjesërisht **3** rekomandime dhe nisur procedurat e zbatimit për **13** rekomandime.
- 2. Masa organizative** janë rekomanduar **279**, nga të cilat janë pranuar **269** masa ose 96.4% e tyre, të pa pranuar 10 masa. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **120** rekomandime, zbatuar pjesërisht **11** rekomandime, kanë nisur procedurat për zbatim **123** rekomandimeve dhe nuk janë zbatuar 15 rekomandime.
- 3. Masa zhdëmtimi** janë rekomanduar **53**, për vlerën 1,249,235 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **45** masa në vlerën 1,234,557 mijë lekë, nuk janë pranuar 7 masa në vlerën 15,278 mijë lekë. Nga masat e pranuar, janë zbatuar **7** rekomandime në shumën 104,645 mijë lekë, pjesërisht 5 rekomandime në vlerën 520,786 mijë lekë në proces zbatimi **26** rekomandime për vlerën 583,888 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 7 rekomandime, për vlerën 24,637 mijë lekë.
- 4. Masa administrative** janë rekomanduar **39**, nga të cilat janë pranuar **39** masa. Nga masat administrative të rekomanduara janë zbatuar **18** masa, në proces **9** masa dhe janë pa zbatuar **12** masa.
- 5. Masa disiplinore** janë rekomanduar **56**, nga të cilat janë pranuar **43** masa, nuk janë pranuar **13** masa. Nga masat disiplinore të rekomanduara janë zbatuar plotësisht **32** masa, janë në proces zbatimi **3** masa dhe nuk janë zbatuar 8 prej tyre.

Bazuar në korrespondencën me subjektet brenda afatit 20 ditor, lidhur me planin e masave për rekomandimet e lëna gjatë kontrollit, rezultoi se nga masat e rekomanduara, nuk janë pranuar 29 rekomandime ose 6.6 %, ku përmendim subjektet:

1. AKSHI, nuk ka pranuar 11 rekomandime.
2. ARRSH, nuk ka pranuar 4 rekomandime.
3. MF, Detyrimet e Prapambetura, nuk janë pranuar 5 rekomandime.
4. Shërbimi Kombëtar i Punës, nuk ka pranuar 2 rekomandime.
5. Avokati i Shtetit nuk ka pranuar 2 rekomandime.
6. Me një rekomandim të pa pranuar rezultojnë subjektet: KQZ, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e përgjithshme e Burgjeve.

Në kundërshtim me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **2 (dy)** subjekte nuk kanë

¹ Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për 3-mujorin e IV të vitit 2015 dhe 9- mujorin e vitit 2016”, të ushtruar në 22 subjektet të audituara janë miratuar me vendimin nr. 193, datë 31/12/2016

kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara (*konkretisht: Shërbimi Kombëtar i Punës dhe Prokuroria e Përgjithshme*). Gjithashtu konstatohen **10 (dhjetë)** subjekte që nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” (*konkretisht: Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Financave, Spitali Universitar i Traumës, Drejtoria e Shërbimit Qeveritar, Agjencia e Prokurimit Publik; Avokati i Shtetit, Qendra e Studimeve Albanologjike, QSUT, Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, dhe Avokati i Popullit*)

MASAT E KËRKUARA PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

1. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR.

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për periudhën 01.01.2014 deri 30.09.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.13, datë 20.02.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 787/14, datë 22.02.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Autoritetin Rrugor Shqiptar, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 1174/2, datë 02.03.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Autoriteti Rrugor Shqiptar, (ARRSH), nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore është lënë **një** rekomandim, i cili, është pranuar plotësisht në proces zbatimi.

2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **14** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 14, janë zbatuar 2, janë në proces zbatimi 9 dhe janë pa zbatuar 3 masa organizative.

3. Për shpërblim dëmi janë lënë **10** rekomandime për shumën 633,638,986 lekë, nga të cilat, janë pranuar 9 rekomandime në vlerën 626,479,954 lekë, një rekomandim në vlerën 7,159,032 lekë është pranuar pjesërisht. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi 4 rekomandime në vlerën 22,062,622 lekë, zbatuar pjesërisht 2 rekomandime në vlerën 500,567,480 lekë, zbatuar plotësisht 1 rekomandim në vlerën 100,001,686 lekë dhe pa zbatuar 3 rekomandime në vlerën 11,007,198 lekë.

4. Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” janë rekomanduar: **9** masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, nga të cilat **4** nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar; **5** masa janë pranuar dhe zbatuar, dhe **1** masë disiplinore “*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj*” e pranuar por e pa zbatuar.

5. Nga APP me vendimin nr. 59, datë 24.06.2016 janë vendosur **22** masa administrative dhe 1 masë disiplinore të detajuara si vijon:

- Për **7** punonjës është vendosur masa administrative - gjobë në vlerën 200,000 lekë, nga ku rezultoi se: për dy punonjës ende nuk ka nisur procesi gjyqësor; për një punonjës ka dalë vendimi i gjykatës i formës së prerë; dhe 4 punonjës rezultojnë të jenë në proces gjyqësor.

- Për **2** punonjës është vendosur masa administrative gjobë në masën 150,000 lekë, nga ku rezultoi se të dy punonjësit janë në proces gjyqësor.

- Për **13** punonjës është vendosur masa administrative gjobë në masën 100,000 lekë, nga ku rezultoi se për një punonjës ka vendim gjyqësor të formës së prerë; 12 punonjës janë në proces gjyqësor, por vlerat ende nuk janë kontabilizuar dhe ende nuk ka filluar arkëtimi i gjobës.

- Një masë disiplinore e propozuar, e cila nuk është realizuar.

Në përfundim rikërkojmë nga Autoritetit Rrugor Shqiptar zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 787/14, datë 22.02.2016, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 5.

Marrjen e masave për të pasqyruar në kontabilitet dhe në bilancin kontabël përmbledhës të vitit 2015 gjatësinë e akteve rrugore konform përcaktimeve të “*Kodit Rrugor*” në një *data base* të hollësishëm gjatësinë dhe vlerën respektive të çdo aksi rrugor, me qëllim që ARRSH të disponojë të dhëna për koston e 1 km rrugë sipas kategorive të mësipërme. Këto të dhëna duhet të konsiderohen jo vetëm si tregues i rëndësishëm për programimi e shpenzimeve të institucionit, por lidhen edhe me për përmbushjen e objektivit të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, përgjegjësitë menaxheriale dhe të strukturave administrative për planifikimin, zbatimin, kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike për hartimin e projektit, preventivit dhe të fondit limit për projekte, ndërtime apo sistemim të akteve rrugore.

Menjëherë

Rekomandimi 6.

Marrjen e masave për miratimin e inventarit të akteve rrugore nga MTI, me qëllim mbylljen e llogarive 202 dhe 231 në shumën prej 206,814,512 mijë lekë dhe debitimin e AQT-ve të përfunduara dhe të kolauduara në llogarinë 213, “*Rrugë dhe rrjete rrugore*”.

Menjëherë

Rekomandimi 14.

Të ketë një praktikë të kujdesshme në ndjekjen dhe likuidimin e shpenzimeve të shpronësimit, të zbatohet parimi FIFO në pagimin e tyre dhe të monitorohen proceset gjyqësore duke nxjerrë gjithmonë përgjegjësi individuale për sa është lejuar kalimi i çështjeve në gjykatë, fakt që krijon kosto shtesë të panevojshme. Rastet e vendimmarrjeve të gabuara të gjykatës të ndiqen deri në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, duke qenë ruajtës të financave publike deri në fund.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.

Të kërkohet shpërblimi i dëmit të konstatuar nga auditimi i kryer pas prokurimit me objekt “*Supervizim dhe auditim për verifikimin e cilësisë së punimeve të objekteve të rrugëve*”, nga shoqëritë sipërmarrëse, për vlerën e plotë të detyrimeve të rezultuara, kolauduara dhe marrë në dorëzim në kundërshtim me Ligjin nr.8402, date 05.09.1994, i ndryshuar “*Për kolaudimin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”. Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Detyrimi në vlerën 495,500,480 lekë, të mbahet nga detyrimet që mund të ketë ARrSH ndaj operatorëve të cilët kanë përfituar nga vëllimi i punimeve të raportuara.

ARRSH të ndjekë procedurat për të siguruar shpërblimin e dëmit të shkaktuar **93,999,102** lekë për subjektet.

1. “...” për vlerën 50,149,236 lekë.
2. “...” për vlerën 35,278,897 lekë.
3. “...” në vlerën 1,142,099 lekë.
4. “...” për vlerën 5,895,131 lekë.
5. “...” për vlerën 1,533,739 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi 3.

Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën prej **7,159,032 lekë**, për sa përfituar padrejtësisht nga shoqëritë sipërmarrëse të mëposhtme:

- a. Shoqëria "...&..." në vlerën prej 720,000 lekë;
- b. Shoqëria "..." në vlerën prej 5,939,032 lekë;
- c. Shoqëria "..." në vlerën prej 500,000 lekë.

Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurës administrative" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqen në vijimësi.

Menjëherë

Rekomandimi 4.

Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën e paargumentuar nga grupi për hartimin e termave të referencës E.N, E.H dhe S.P, për llogaritjen e fondit limit më tepër, pasi në preventiv janë parashikuar zëra që tejkalojnë afatin ligjor të kryerjes së shërbimit të vendosur në DST (*termat e referencës*) për tenderin me objekt "Supervizim dhe auditim për verifikimin e cilësisë së punimeve të objekteve të rrugëve", duke sjellë si pasojë rritjen artificiale të tij. Nga llogaritjet e grupit të auditimit vlera minimale e shtuar arrin në **1,120,000 lekë**. Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurës administrative" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

Menjëherë

Rekomandimi 5.

Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **2,728,166 lekë**, nga hartuesit e fondit limit respektivisht; z. S.P, znj.D,Sh, z.A.Z. Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurës administrative" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

Menjëherë

Rekomandimi 6.

Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **4,050,000 lekë**, respektivisht nga:

1. Z.K vlere prej 4,050,000 lekë.

Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi, arkëtimi i vlerës së mësipërme.

Menjëherë

2. AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI).

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare" për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 84, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1134/20, datë 04.07.2016, vendimit të Kryetarit nr. 129, dt. 30.09.2016 përcjellë me shkresën nr. 1134/41, dt. 13.10.2016 konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", AKSHI, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 1997/1, datë 28.07.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 3 rekomandime, të cilat, janë pranuar plotësisht dhe, janë në proces zbatimi 3 me afat zbatimi brenda vitit 2016.

2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 12, nuk janë pranuar 2. Janë zbatuar 2, dhe në proces zbatimi janë 10.

3. Për shpërblim dëmi janë lënë rekomandime për shumën **21,962,894** lekë, nga të cilat, 1(një) propozuar për verifikim nga strukturat e brendshme në shumën **10,827,000** lekë, dhe pranuar 3 masa shpërblim dëmi në vlerën **11,135,894** lekë, të cilat rezultojnë në proces zbatimi.

4. Është lënë **1** rekomandim për shpenzime pa efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën **132,511** mijë lekë i pranuar plotësisht dhe në proces zbatimi.

5. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar 12 masa disiplinore: **4** masa disiplinore “Largim nga Detyra”, nga të cilat **3** nuk janë pranuar ndërsa masa e pranuar është zbatuar; **3** masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”, nga të cilat **2** nuk janë pranuar ndërsa masa e pranuar është zbatuar; **5** masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” deri “Vërejtje me paralajmërim” nga të cilat **2** janë pranuar dhe zbatuar kurse **3** nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar.

Në përfundim rikërkojmë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 11340/20, datë 04.07.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Rekomandim 1.

Strukturat drejtuese të këtij Institucioni, Sektori i Financës dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e investimeve në Ministrinë e Financave, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, shpenzimet e domosdoshme të investimeve për arritjen e objektivave. Programimi i investimeve të jetë i specifikuar që në projekt-ide e deri në realizimin e tyre, në mënyrë që të mos rezultojë formal i gjithë programimi për investimet dhe të shmangen ndryshimet materiale, nga faza e programimit të PBA e deri tek plani përfundimtar vjetor i investimeve.

Të analizohen kostot e produkteve të programuara dhe të realizuara dhe të analizohet performanca financiare e tyre si pjesë e kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Menjëherë

Rekomandim 2.

Nga ana e AKSHI-t, për çdo projekt të propozuar, të ketë studime të thelluara dhe konkurrim të hapur për projekte dhe ide novatore, duke mos mbetur vetëm në kuadrin e punës së punonjësve dhe specialistëve të Institucionit, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë kualifikimet apo dhe kompetencën për të hartuar projekte të natyrave të tilla. Çdo projekt i propozuar të ketë analiza të mirëfillta teknike dhe financiare në mënyrë që vendimmarrja të bazohet në analizën kosto-përfitim.

Nga ana e AKSHI-t të ketë analizë reale tregu për çdo element të projekteve dhe kosto e tyre të merret nga kompani që operojnë në tregjet ndërkombëtare, çmimet e të cilave bazohen në preventiva transparent, duke eliminuar praktikën e përcaktimit të vlerës së këtyre projekteve nga vetë operatorët e tregut, të cilët më pas në procedurat e tenderimit, janë konkurrentët për fitimin e kontratave të zbatimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

2. Nga auditimi i procedurës “Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit të Access Control, sistemit BMS, sistemit të kondicionimit dhe shërbimi i pastrimit të Qendrës të të Dhënave Qeveritare”, rezultoi se në këtë Autoritet Kontraktor ka patur një kontratë, me nr. 1135/1, datë 13.12.2010, sipas të cilës duhet të kryeshin shërbimet e mësipërme, e cila përfundon në 11.03.2016, fakt që duhet të kishte shmangur kryerjen e kësaj

procedure. Rezulton të ketë mbivendosje kohore në dy objekte prokurimi, për të njëjtin qëllim, për rreth 18 muaj. Nisur nga oferta e OE fitues, AK ka paguar shërbimet periodike në ambientet e D C, ndërkohë që këto shërbime ishin nën kontratë, në vlerën 10,827 mijë lekë (601,500 lekë/muaj (oferta e kontratës nr. 1383, datë 29.09.2014) x 18 muaj).

Për sa më sipër rekomandoj:

- *Propozuar për verifikim nga strukturat e brendshme* te vlerës prej **10,827,000 lekë**, nga mbivendosja në kohë e dy objekteve prokurimi për të njëjtin qëllim.

-Nga ana e institucionit në lidhje me problemet e ngritura për rekomandimin e mësipërm, në shkresën nr. 1134/44, datë 20.10.2016, për procedurën me objekt “*Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit Acces controll, Sistemit BMS, Sistemit të Kondicionimit si dhe Shërbimit i Pastrimit në Qendrën e të Dhënave Qeveritare*” të merren masa për paraqitjen pranë KLSH-së të dokumenteve mbi pretendimin e mbivendosjes se dy procedurave të prokurimit të zhvilluara në kohë të ndryshme me objekte të ndryshme.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandoj e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Largim nga Detyra”, në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës, për personat si më poshtë:*

- 1. Z. V.P**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Kërkimit dhe Zhvillimit e-Gov;
- 2. Z. Y.Ç** me detyrë Drejtorisë së Bazës së të Dhënave Shtetërore;
- 3. Z. D.SH**, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Investimeve në TIK, me cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike në procedurat e prokurimit me blerje të vogla.

D.2. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandoj e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”, në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës për 2 (dy) persona, si më poshtë:*

- 4. L.B**, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Përditësimit të Shërbimeve të Portalit e-Albania,
- 5. S.Gj** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të standardeve TIK;

D.4. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandoj e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” deri “Vërejtje me paralajmërim”, në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës për 5 (pesë) persona, si më poshtë:*

- 6. I.D** me detyrë specialist në Sektorin e Administrimit të Rrjetit GovNet.
- 7. B.V**, me detyrë drejtore e Drejtorisë së Vazhdimësisë së Punës BCC, Back-up dhe DRC.
- 8. M.S** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Sistemeve.

3. MINISTRIA E FINANCAVE.

(MBI PROCESIN E SHLYERJES SË DETYIMEVE TË PRAPAMBETURA PËR VITIN 2014 NË MINISTRINË E FINANCAVE).

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Financës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 143, datë 17.10.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 307/9, datë 17.10.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Ministria e Financës i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr.7100/38, datë 10/11/2015, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Ministria e Financës, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se:

Janë rekomanduar gjithsej për përmirësimin e gjendjes 6 masa organizative, nga të cilat, është pranuar dhe realizuar vetëm 1 masë organizative, si rrjedhim nuk janë pranuar dhe realizuar 5 masa organizative.

Nisur nga fakti që mos pranimit i masave organizative ishte i lidhur edhe me momentin e dhënies së masave (*afër fundit të procesit të shlyerjes së këtyre detyrimeve*), por duke vlerësuar masat si të domosdoshme në kushtet kur po mendohet një skemë e tillë për shlyerjen e borxhit të pushtetit vendor, borxh që cilësohet i lartë për fondet e alokuara për pushtetin vendor, e gjykojmë të rëndësishme të jenë në vëmendje të Ministrisë së Financave, pjesë të rekomandimeve të papranuara të këtij auditimi të cilat janë në koherencë të plotë me situatën e borxhit vendor si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandimi 1.

Nga ana e Ministrisë së Financave të iniciohet një mision verifikimi, për saktësimin e detyrimeve të klasifikuara dhe të raportuara si detyrime të prapambetura, (në çdo rast të evidentimit të niveleve të larta të këtyre borxheve), shoqëruar me masa konkrete për të përcaktuar shumën e detyrimeve që do të përfitojnë nga strategjia e hartuar nga Qeveria Shqiptare në mënyrë të saktë, transparente, të besueshme dhe të përcaktohet gjurma e auditimit. E vlerësojmë të domosdoshme që procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të fillojë vetëm pasi të jetë saktësuar lista e detyrimeve që do të përfitojnë nga fondet nën Strategjinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, listë që nuk mund të ketë shtesa dhe ndërhyrje si ato të konstatuara deri në këtë proces auditimi.

Në vijimësi

Rekomandimi 2.

Nga Ministria e Financave të merren masa që fondet e huamarrjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të paraqiten me saktësi sipas kërkesave të ligjit të buxhetit.

Në vijimësi

Rekomandimi 3.

Nga Ministria e Financave të realizohet një ndërhyrje e studiuar dhe e menjëhershme, në mënyrë që të përcaktohet në mënyrë eksplicite lloji i detyrimeve që mund të mbulohen nisur nga konteksti i një borxhi të shëndetshëm duke pasur në vëmendje efektet në rritje në borxhin publik dhe në zhvillimet makro të kësaj strategjie shoqëruar edhe me indikatorë që do të mundësonin ndjekjen e nivelit të detyrimeve të prapambetura në vijimësi pavarësisht nëse hyjnë në strategjinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura apo jo.

Në vijimësi

Rekomandimi 6.

Të monitorohet respektimi në mënyrë strikte i radhës së shlyerjes së detyrimeve për secilën kategori të detyrimeve të papaguara, duke ndjekur parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar sipas sektorëve, nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga institucionet përkatëse etj, pasi nuk mund të ketë më justifikim verifikimi i detyrimeve që përfitojnë nga kjo strategji (FIFO).

Në vijimësi

4. MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE E RINISË.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale e Rinisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 98, datë 23.07.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 228/7, datë 23.07.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 4533/1, datë 20.09.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 13 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë në proces zbatimi 10, pa zbatuar 2 masa dhe pjesërisht e realizuar 1.

2. Për shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime për shumën 10,379,783 lekë, të cilat janë pranuar, dhe nga këto konsiderohen të zbatuara 3 masa shpërblim në vlerën 4,309,470 lekë dhe të pa zbatuara 3 masa në vlerën 6,070,313 lekë.

3. Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë rekomanduar: 2 masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil” masë e pranuar dhe konsiderohet e zbatuar pasi punonjësit nuk janë në marrëdhënie pune me MMSR, 1 masë disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, masë e pranuar dhe konsiderohet e zbatuar pasi punonjësit nuk janë në marrëdhënie pune me MMSR, dhe 3 masa disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi;

4. Nga APP nuk ka vendim për 9 masat administrative të propozuara nga KLSH.

Në përfundim rikërkojmë nga Ministria e Mirëqenies Sociale e Rinisë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 228/7, datë 23.07.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandim 9.

Autoriteti Kontraktor i MMSR-së, të marrës masa që, në fillim të çdo viti kalendarik të ngrihet Njësia e Prokurimit me anëtarë të trajnuar. Të shmanget fiktiviteti në studimin e tregut për prokurimet për blerje mallra, duke marrë oferta nga ato subjekte që kanë si aktivitet kryesor mallin, shërbimin që do prokurohet. Dokumentet e tenderit të hartohen dhe paraqiten në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar për çdo kriter të veçantë.

Anëtarët, në grupet e punës për llogaritjen e vlerës së kontratës dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përzgjidhen nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duke qenë specialistë të fushës së prokurimit ose të aplikohet marrja e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, sidomos për punimet e ndërtimeve të reja apo rikonstruksionet (*specialist të fushës së ndërtimit*), me qëllim që të rritet efienca e përdorimit të burimeve dhe fondeve publike në dispozicion të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandim 11.

Të rakordohet puna në institucion dhe të bashkëpunohet me Departamentin e Administratës Civile, për sistemimin në vendet e punës apo të ngjashëm, të pesë punonjësve që me vendim gjykatë të formës së prerë duhen rikthyer në vendet e tyre të punës, duke shfrytëzuar pozicionet vakante në strukturën e ministrisë apo njësitë e varësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtoria e Financës të kërkojnë nga projekti Risi Albania, dokumentacionin origjinal lidhur me shpenzimet e kryera, të verifikojë nëse shpenzimet janë në përputhje me komponentët e projektit, në rast të kundërt nga MMSR të merren të gjitha masat për ndjekjen në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës prej **5,940,133** lekë likuiduar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin*”, neni 4, pika 26.

Menjëherë

Rekomandim 3.

KVO të përbërë nga T.T kryetar, F.S dhe E.H vlerën 77,650 lekë pa TVSH ose 93,180 lekë me TVSH, ose nga 25,883 lekë/secili pa TVSH ose 31,060 lekë me TVSH, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “...” sh.p.k. të kualifikuar në vend të dytë padrejtësisht dhe “...” sh.p.k. të shpallur fitues, në kundërshtim me KVK e miratuar me DST, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1“*Objekti dhe qëllimi*”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar. Gjithashtu, MMSR, të marrë masa që në mbështetje në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “*Kodi i Procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë*”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik*”, kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MMSR të nxirren aktet administrative, për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën totale **77,650** lekë pa TVSH, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. DREJTORIA E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 23, datë 28.03.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1132/8, datë 28.03.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 2055/17, datë 08.04.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën nr. 2055/33, datë 10.06.2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- 1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 13 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 13, dhe janë zbatuar plotësisht 7 prej tyre, janë në proces 5 dhe pa zbatuar 1 rekomandim.**
- 2. Për shpërblim dëmi janë lënë 5 rekomandime me vlerën 9,818,283, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 me vlerën 7,292,249 lekë, nuk është pranuar 1 me vlerën 2,526,044 lekë. Nga masat 1 është zbatuar plotësisht me vlerën 32,306 lekë, 1 masë në vlerën 3,279,097 në proces dhe 2 masa në vlerën 3,980,836 lekë zbatuar pjesërisht.**
- 3. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, e cila është pranuar por rezultoi e pa zbatuar.**

Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1132/8, datë 28.03.2016, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 5.

Të merren të gjitha masat e duhura, në përputhje me dispozitat ligjore për statusin e nëpunësit civil, për plotësimin e organikës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm me qëllim mos cenimin e funksionimit normal të kësaj strukture të rëndësishme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

4. DPB në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrinë e Financave, për efekt të zbatimit të katër vendimeve të formës së prerë të gjykatave për personat sipas listës bashkëngjitur, në të cilat ato janë shprehur ... *për pagesën e personit, deri në kthimin e tij në punë*, të marrë masat e nevojshme për të siguruar derdhjen në fondin e sigurimeve shoqërore të shumës së munguar prej **2,526,044 lekë**, e cila përfaqëson detyrimet e pa paguara të punëdhënësit/institucionit ndaj punëmarrësit/personave që kanë fituar procesin gjyqësor.

Menjëherë

6. SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMES.

Nga auditimi i ushtruar në *Qendrën Spitalore Universitare e Traumës* për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*" për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 171, datë 28.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.788/7, datë 28.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Qendra Spitalore Universitare e Traumës i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 34 datë 18.01.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve. Qendra Spitalore Universitare e Traumës, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë nuk lënë rekomandime.
2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18 masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 18, nuk ka masa të pa pranuar nga subjekti, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 6, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces 9 dhe të pa zbatuara 1 rekomandim.
3. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **3** rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht **3**, nga të pranuarat, janë në proces zbatimi **2**, dhe të pa zbatuara **1** rekomandim.
4. Janë rekomanduar **10 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet; Sipas **Kodit të Punës** 10 masa disiplinore e përkatësisht; "**Vërejtje**" 9 masa nga të cilat 9 pranuar, dhe 9 zbatuar; "**Zgjidhje e kontratës së punës**" 1 masë nga të cilat nuk është pranuar, por është zëvendësuar më masën "**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**"

Qendrës Spitalore Universitare e Traumës **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr.788/7, datë 28.12.2015, mbi auditimin me objekt "*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Rekomandim I.

Nga SUT, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, **në shumën 8,267,033 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për rastet e mëposhtme:

1. Nga auditimi konstatohet se, nga subjekti “...” janë përdorur *pa kontratë dhe pa pagesë sipërfaqja e tepërt prej 1200 m²*, referuar kontratës së qirasë së datës 28.08.2013, të lidhur me ish Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, duke i shkaktuar SUT dëm ekonomik në shumën 7,560,000 lekë.

Menjëherë

7. DREJTORIA E SHËRBIMIT QEVERTAR.

Nga auditimi i ushtruar në *Drejtoria e Shërbimit Qeveritar* për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 150, datë 11.11.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 654/7, datë 11.11.2015, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, *Drejtoria e Shërbimit Qeveritar*, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 645, datë 07.12.2015 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

-Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, *Drejtoria e Shërbimit Qeveritar*, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore dhe nënligjore** nuk janë lënë rekomandime.
2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 8 **masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 8, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 8 rekomandime.
3. Për **shpërblim dëmi** është lënë 1 rekomandim, e cila pas shqyrtimit në Agjencinë e Prokurimit Publik nuk është vlerësuar si dëm ekonomik.
4. Është rekomanduar 1 **masë disiplinore**, gjendja e të cilës paraqitet; Nuk është marrë në konsideratë nga institucioni dhënia e masës disiplinore “Zgjidhje e menjëhershme e kontratës të punës”, Sipas **Kodit të Punës** Imasë disiplinore e përkatësisht “Zgjidhje e kontratës së punës” e cila nuk është pranuar nga institucioni.
5. Janë rekomanduar 8 **masa administrative**, gjendja e të cilave paraqitet; Kërkuar APP, 8 **masa administrative**, e përkatësisht; “Dënim me gjobë në vlerën 50,000 lekë” 3 persona, masë e cila nuk është marrë në konsideratë nga APP si, për pesë persona dhënia e masës “Vërejtje” e cila është marrë në konsideratë nga APP dhe ekzekutuar nga institucioni.

Drejtoria e Shërbimit Qeveritar **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 654/7, datë 11.11.2015, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 37 e 140 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar si dhe në kontratën e punës, titullari i Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“**Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës**” për:

z. O.P., me detyrë Drejtor i Njësisë së Organizimit, Shërbimit dhe Trajtimit në Rezidenca.

8. AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK.

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë e Prokurimit Publik për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin IT*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 168, datë 27.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 427/10, datë 27.12.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Agjencia e Prokurimit Publik, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr.5273/9, datë 18.01.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Agjencia e Prokurimit Publik, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 5, janë në proces 4 dhe është i pazbatuar 1 rekomandim.

Agjencisë së Prokurimit Publik **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 427/10, datë 27.12.2015, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Rekomandimi 3.

APP të marrë masa për hartimin e politikave të trajnimit të Burimet Njerëzore në fushën e teknologjisë së informacionit, të vendosi standarde për trajnime të vijueshme të stafit, duke përcaktuar një numër të caktuar ditësh trajnimi për çdo funksion kryesor të lidhur me realizimin me sukses të objektivave institucional.

Në vijimësi

9. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nga auditimi i ushtruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 88, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.1131/16, datë 04.07.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 2964, datë 27.07.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore është lënë 1 rekomandim, i cili është pranuar plotësisht, dhe ky rekomandim është në proces zbatimi.

2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 6, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 2, janë në proces 3 dhe është i pazbatuar 1 rekomandim.

3. Për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat është pranuar plotësisht 1 dhe 1 rekomandim rezulton i papranuar. Një rekomandim për shpërblim dëmi është i zbatuar.

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve **i kërkojmë** përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr.1131/16, datë 04.07.2016, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi kanë rezultuar në proces.

10. SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËS

Nga auditimi i ushtruar në Shërbimin Kombëtar të Punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.73, datë 29.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.1135/12, datë 04.07.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Shërbimi Kombëtar të Punës, nuk ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 6 masa organizative, të pranuar, nga të cilat zbatuar plotësisht 1, në proces zbatimi 2 dhe të pa zbatuara 2 rekomandime, zbatuar pjesërisht 1 rekomandim.

2. Për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat 2 nuk janë pranuar.

Shërbimi Kombëtar të Punës **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën 1135/12, datë 04.07.2016,, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandim 1.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit të marrë masa për plotësimin e Rregullores së Brendshme, duke përcaktuar jo vetëm funksionet por dhe përshkrimin e punës për çdo pozicion pune, për të cilët të vendosen edhe kriteret e rekrutimit të personelit konform dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

Rekomandim 2.b

Mënyra e përcaktimit të kostove që mbulohen nën programet e nxitjes duhet të jetë e analizuar dhe transparente, sidomos nëse i referohemi kostove të trajnimit.

Menjëherë

Rekomandim 5,

Duke qenë se në marrëveshjet e bashkëpunimit kërkohet që shpenzimi i fondeve të bëhet në përputhje me rregulloren financiare të institucionit, është nevojë emergjente hartimi dhe miratimi i rregullores financiare të brendshme që të reflektojë, jo vetëm kërkesat ligjore por edhe praktikën më të mira në shpenzimin e fondeve të përfituara nga donatorët e huaj.

Menjëherë

Titullari i institucionit të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për plotësimin e pasaktë të urdhër shërbimeve të periudhës 01.01.2014-31.12.2015 dhe mungesën e sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit lidhur me këtë lloj shpenzimi.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit për vlerën **1,007,500** lekë:

1. Gjatë auditimit të shpenzimeve për dieta brenda vendit për vitin 2014 u konstatua se, janë likuiduar shpenzime për fjetje në hotel pa dokumente shoqërues të urdhër shërbimit, Faturë Tatimore Shitje për fjetje në hotel dhe kupon tatimor, 15 persona përfitues vlera në total 238,500 lekë. Janë kryer pagesa për fjetje për qytetin e Shkodrës, largësia e të cilit është nën 100 km, për 31 persona përfitues në vlerë totale 204,500 lekë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”.

Për vitin 2015, shpenzimet për dieta brenda vendit (shpenzime fjetje në hotel) pa dokumente shoqërues të urdhër shërbimit, Faturë Tatimore Shitje për fjetje në hotel dhe kupon tatimor, 5 persona përfitues vlera në total 24,000 lekë. Pagesa për fjetje në qytetin e Shkodrës, i cili është nën 100 km dhe nuk përfshihet në dieta me akomodim, 26 persona përfitues, në total 189,500 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”.

2. Gjatë auditimit të shpenzimeve për udhëtim e dieta për vitin 2014, u konstatua se, janë likuiduar shpenzime për fjetje në hotel, në 83 raste (netë), me vlerë 249,000 lekë pa dokumente shoqërues, Faturë Tatimore Shitje dhe kupon tatimor, në kundërshtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit me nr. 844 prot. datë 02.05. 2013, të nënshkruar ndërmjet PNUD dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, mbi zbatimin e projektit nr. 00080624 me titull “Për sfidat e punësimit të rinjve në nivel lokal”, shtojca III, Lista e aktiviteteve, Lehtësitë dhe Pagesat” ku përcaktohet: Shërbimi Kombëtar i Punësimit do ti mbulojë shpenzimet ditore për transport dhe qëndrim prej 5,000 lekë/ditë dhe 8,000 nëse ka qëndrim dhe fjetje, për stafin që ndjek trajnimin, si dhe me pikën 3 ku citohet: Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të jetë përgjegjës i plotë për zbatimin me kujdes dhe efikasitet të të gjitha aktiviteteve në përputhje me Rregulloren e tij financiare dhe rregullat e tij.

Dietat e përfituara nuk janë paguar në përputhje me një dokumentacion të rregullt sipas kërkesave ligjore në fuqi duke rezultuar si shpenzime të padokumentuara për fondet e përfituara nga grandit e fituar, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit tabela nr. 3.

Gjatë auditimit të shpenzimeve për udhëtim e dieta për vitin 2015, u konstatua se, janë likuiduar shpenzime për fjetje në hotel, në 34 raste (netë), gjithsej në shumën 102,000 lekë, pa dokumente shoqërues, Faturë Tatimore Shitje dhe kupon tatimor, në kundërshtim me marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet palëve me nr. 1245 prot. datë 21.04. 2015 për Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe nr. 173 prot, datë 21.04.2015 për Sëiscontact, Shqipëri, mbi zbatimin e projektit “Këshillimi drejt punësimit dhe sipërmarrjes” shtojca 1 “Etapat dhe bashkëpunimi financiar”, etapa III Kontributet Financiare pika d, në të cilën përcaktohet: Shërbimi Kombëtar i Punësimit do ti paguajë stafit të përfshirë në këto aktivitete një tarifë pjesëmarrje/dietë (shpenzime udhëtimi prej 8,000 lekë, në rast akomodimi). Dietat e përfituara nuk janë paguar në përputhje me një dokumentacion të rregullt sipas kërkesave ligjore në fuqi duke rezultuar si shpenzime të pajustificuara për fondet e përfituara nga grandit e fituar.

11. AVOKATI I SHETIT.

Nga auditimi i ushtruar në Avokatin e Shtetit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 139, datë 30.9.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 264/8, datë 12.10.2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Avokati i Shtetit, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 484/12, datë 02.12. 2015,

ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Avokati i Shtetit, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e *dispozitave ligjore* dhe nënligjore është lënë *një* rekomandim, i cili është pranuar dhe është zbatuar nga subjekti.

2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë *4 masa organizative*, nga të cilat, janë pranuar plotësisht dy rekomandime, nuk janë pranuar dy rekomandime. Nga rekomandimet e pranuar janë zbatuar plotësisht dy rekomandime dhe dy rekomandime janë të pa zbatuara.

3. Është propozuar *një* masë shpërblim dëmi e cila është në proces zbatimi.

Nuk janë rekomanduar masa disiplinore.

Avokatit të Shtetit, Tiranë ***i rikërkojmë*** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 264/8, datë 12.10.2015, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 4.

Avokatura e Shtetit, bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit 16 të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “*Për Avokaturën e Shtetit*”, ti drejtohet MZHETS-it për dërgimin e një kërkesë zyrtare dhe vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, në lidhje me iniciimin dhe ndjekjen me prioritet absolut nga ana e saj, të çështjes së arkëtimit të garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “...” në procedurat e privatizimit të shoqërisë “...” në vlerën 85 milion Euro. Theksojmë se bashkëpunimi midis Avokaturës së Shtetit dhe MZHETS duhet të jetë i vazhdueshëm deri në arkëtimin e vlerës prej 85 milionë euro në buxhet.

Menjëherë

Konstatohet se në vijimësi, KLSH i është drejtuar Avokatit të Shtetit me shkresën nr. 264/10, datë 31.10.2015 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku i është kërkuar MZHETS – it që të dërgojë dosjen e privatizimit të Albpetrol, pranë institucionit të Avokatit të Shtetit, gjë e cila është realizuar nga MZHETS nëpërmjet shkresës nr. 8291/2, datë 20.11.2015.

Për sa konstatohet në çështjen e mësipërme Avokati i Shtetit e ka limituar aktivitetin e vetë, vetëm në korrespondenca shkresore, pa ndërmarrë veprime të mëtejshme për realizimin e këtij rekomandimit duke lejuar tejkalimin e afateve në kërkimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar, në vlerën 85 milionë lekë.

Nga Kuvendi i Shqipërisë të kërkohet përdorimi i mekanizmave përkatëse, për të siguruar që nga ana e Avokatit të Shtetit dhe Ministrive respektive, të merren të gjitha masat e rekomanduara, deri në arkëtimin e vlerës prej 85 milionë euro në buxhet. (*pika 24 e projekt vendimit*)

12. QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE.

Nga auditimi i ushtruar në Qendrën e Studimeve Albanologjike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 26, datë 31.3.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.1027/8 datë 31/3/2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Qendra e Studimeve Albanologjike nuk ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve.

Qendra e Studimeve Albanologjike, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 33 masa organizative nga cilat janë zbatuar plotësisht 12, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces 14 dhe janë të pa zbatuara 5 rekomandime.

2. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, sipas Kodit të Punës masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, e cila është zbatuar.

Qendrës së Studimeve Albanologjike **i rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1027/8 datë 31/3/2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandim 4.

Nëpunësi Autorizues në mënyrë të menjëhershme, të propozojë në linjë hierarkike deri tek Titullari masa lidhur me trajtimin e mëtejshëm të aktivitetit të dëmtuar/humbur, si dhe masa administrative ndaj shkaktarëve deri në ndjekjen penale të tyre.

Për të shmangur raste të tilla flagrante, Titullari i Institucionit të hartojë procedurat specifike në lidhje me masat që do të ndërmerren për kompensimin, zëvendësimin dhe / ose riparimin e aktiveve, ku të parashikohen mënyra e vlerësimit të dëmit (në bazë të vlerës së drejtë, e cila asnjëherë nuk mund të jetë më të vogël se vlera e tyre kontabël) në rastet kur konstatohen prishje dhe dëmtime në aktivitet afatgjatë materiale, e që u ngarkohen fajtorëve.

Menjëherë

Rekomandim 12.

Institucioni të marrë masa të bëjë gjithë sistemimet e domosdoshme në mbyllje të pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2015, duke u mbështetur mbi parimin e të drejtave të konstatuara.

Menjëherë

Rekomandim 14.

Institucioni të marra masa të hartojë Rregulloren e Brendshme, ku të përcaktohen qartë mënyra e përdorimit të të ardhurave, sa i takon administrimit dhe kontabilizimit, me qëllim rritjen e transparencës dhe efektivitetit të procesit të planifikimit dhe zbatimit të këtyre planeve, për të ardhurat e krijuara nga vetë institucioni.

Menjëherë

Rekomandim 18.

Institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të angazhohen në tërheqjen e materialeve të ruajtura pranë ish Laboratorit të Konservimit dhe Arkeometrisë me qëllim vlerësimin e përdorshmërisë së tyre, si dhe të vlerësohet mundësia e rindërtimit të tij në një vend tjetër të përshtatshëm.

Menjëherë

13. ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR.

Nga auditimi i ushtruar në Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 39, datë 25.4.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1133/5, datë 13/04/2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 611/15, datë 04/05/2016.

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën nr. 611/16, datë 12.10.2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 14 dhe nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 6, janë zbatuar pjesërisht 1 dhe janë në proces 7 masa organizative.

*2. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet; Sipas Statusit të Nëpunësit Civil Imasë disiplinore e cila ka kaluar të gjithë praktikën e gjyqimit nga Komisioni Disiplinor në përmbushje të rekomandimit të lënë në raportin e auditimit dhe e ka cilësuar si të padrejtë konstatimin e KLSH për marrjen e masave disiplinore duke pezulluar procesin. Konsiderohet e **pa realizuar***

Nisur nga fakti që ky institucion do të suprimohet nën reformën e re të drejtësisë, nuk do të drejtohem për të rikërkuar zbatimin e masave.

14. NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 105, datë 19.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 229/12, datë 20.09.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria e Shëndetësisë, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr.1162/6, datë 06.10.2015, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 28 masa organizative, nga të cilat nuk është pranuar 1 dhe janë në proces zbatimi 27.

2. Për shpërbllim dëmi janë lënë 5 rekomandime për shumën 33,672,484 lekë të arkëtueshëm dhe 1 masë për dëm ekonomik të pa arkëtueshëm në vlerën 6,244,058 lekë, të cilat, janë pranuar, dhe janë në proces zbatimi 5 rekomandime shpërbllim dëmi në vlerën 33,672,484 lekë.

Nisur nga fakti se Ministria e Shëndetësisë, ka hartuar planin e zbatimit të rekomandimeve vetëm në fund të muajit shtator, do të drejtohem për të inkurajuar përshpejtimin e zbatimit të masave që janë në proces.

15. NË MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 180, datë 30.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 784/5, datë 30.12.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 7766/1, datë 29.10.2015 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën nr.488/1, datë 20.01.2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe është lënë **1 rekomandim**, i cili është pranuar plotësisht dhe realizuar pjesërisht.
2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **15 masa organizative**, nga të cilat, janë zbatuar plotësisht 6, zbatuar pjesërisht 3, janë në proces 6.
3. Për **shpërblim dëmi** është lënë **1 rekomandim me vlerën 16,238,155 lekë** i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.
4. Është rekomanduar **1 masë disiplinore**, e cila është e zbatuar.

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nuk do t'i drejtohem për të rikërkuar zbatimin e masave do t'i drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

16. QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”.

Nga auditimi i ushtruar në *Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”* për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 37, datë 24.12.2015 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 789/12, datë 15.01.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 5134/64, datë 06.05.2016, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore nuk janë lënë rekomandime,
2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht 18 rekomandime.
3. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **10 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 të cilat janë në proces zbatimi dhe nuk është pranuar 1.
4. Janë rekomanduar **2 masa** për përdorimin me eficence dhe efektivitet të fondeve publike nga të cilat janë pranuar plotësisht 2 dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.
5. Janë rekomanduar **7 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet;
Sipas **Kodit të Punës**: “Në kompetencë të Titullarit” 7 masa disiplinore nga të cilat 7 pranuar, dhe 7 zbatuar;

Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” do t'i drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

17. INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE.

Nga auditimi i ushtruar në *Institutin e Sigurimeve Shoqërore* për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar

në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 63, datë 17.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 135/7, datë 20.06.2016, konstatohet se: Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 4288/3, datë 26.07.2016 ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- 1. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 14 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14, nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 8, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces 4 rekomandime.*
- 2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 11 **masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 11, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 8, janë në proces 3 rekomandime.*

Instituti të Sigurimeve Shoqërore do t'i drejtohem për të inkurajuar përshpejtimin e zbatimit të masave që janë në proces.

18. DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE QYTETIT, TIRANË.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Arsimore Rajonale Qytetit, Tiranë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 83, datë 26.7.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1129/5, datë 26.4.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtorja Arsimore Rajonale Qytetit, Tiranë, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 1530/9, datë 16.5.2016, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Drejtorja Arsimore Rajonale Qytetit, Tiranë, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

- 1. Për përmirësimin e **dispozitave ligjore** dhe nënligjore janë lënë 2 rekomandime për MAS, nga të cilat janë **proces zbatimi**.*
- 2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 **masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 9, dhe 1 në proces.*
- 3. Për **shpërblim dëmi** janë lënë 2 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2, nga të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 2.*

Drejtorisë Arsimore Rajonale Qytetit, Tiranë nuk do t'i drejtohem për të inkurajuar përshpejtimin e zbatimit të masave që janë në proces.

19. AKADEMIA E SHKENCAVE.

Nga auditimi i ushtruar në Akademinë e Shkencave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 20, datë 29.02.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1130/5, datë 22.02.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Akademia e Shkencave, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 484/12, datë

02.12.2015, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Akademia e Shkencave, ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën nr. 312, datë 31.08.2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 3 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 3, janë zbatuar plotësisht 1, janë në proces 2 rekomandime.

2. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 5, janë zbatuar plotësisht 3, dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime.

Akademisë së Shkencave nuk do t'i drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

20. AVOKATI I POPULLIT.

Nga auditimi i ushtruar në Avokatin e Popullit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 83, datë 26.7.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 785/7 datë 26/12/2015, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Avokati i Popullit, i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 200/20, datë 20.01.2016, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Avokati i Popullit, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 17 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 11, janë zbatuar pjesërisht 1 dhe janë në proces 5 rekomandime.

2. Për shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim, që është në proces.

Avokatit të Popullit nuk do t'i drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

21. INSPEKTORIAT I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE (ILDKPKI).

Nga auditimi i ushtruar në Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 72, datë 29.6.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 269/7, datë 30/06/2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), i ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve me shkresën nr. 3234/1, datë 22.07.2016, ku pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ka kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën nr. 3234/2 datë 24.11.2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

1. masa organizative 5, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5.

Duke konstatuar sa më sipër, nuk do t'i drejtohem Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

22. PROKURORIA E PËRGJITHSHME.

Nga auditimi i ushtruar në *Prokurorinë e Përgjithshme* për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "*Mbi zbatimin e rregullshmërisë ekonomiko-financiare*" trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin 49, datë 27.9.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 531/4, datë 27/09/2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Prokuroria e Përgjithshme nuk ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve. Ndërkohë me shkresën nr.1538/5, datë 30.09.2016, pranohen pjesërisht rekomandimet e lëna dhe është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 11 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 11, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 4 dhe janë në proces 7 rekomandime.

Prokurorisë së Përgjithshme nuk do t'i drejtohem për të inkurajuar përsheptimin e zbatimit të masave që janë në proces.

23. REKOMANDIME TË PAZBATUARA PËR LARGIM NGA DETYRA TË DISA DREJTUESVE TË LARTË.

Nga auditimi konstatuam se, nuk janë zbatuar rekomandimet për largim nga detyra të funksionarëve të lartë, si më poshtë:

- Fillimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore "*Shkarkim nga detyra*", për Drejtorin e Përgjithshëm të ARRSH-së, **Z. D.Xh**, rekomanduar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 13, datë 20.02.2016.

- Fillimi i procedurave për dhënien e masës disiplinore nga "*Vërejtje*" deri në "*Largim nga puna*" për **Znj. O.M**, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT, rekomanduar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 37, datë 12.04.2016.

-

- Vlerësimin e shkeljeve nga ana e Departamentit të Administratës Publike, duke vendosur marrjen e masës disiplinore "*Largim nga shërbimi civil*" për :

a. Znj. I.N, ish Sekretar i Përgjithshme në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, aktualisht Drejtor në Bashkinë e Tiranës; dhe

b. Znj. J.H, ish Drejtor i Financës në MMSR, aktualisht Drejtor në Bashkinë e Tiranës. Rekomanduar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 98, datë 23.07.2016.

- Ja kemi lënë në kompetencë Ministrin përgjegjës për turizmin (sot Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes), të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore "*Shkarkim nga detyra*" për:

- Znj. **J.Dh**, ish Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, aktualisht Drejtor i Përgjithshëm në Bashkinë e Tiranës.

Rekomanduar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 45, datë 30.04.2015.

24. DISA REKOMANDIME, QË KËRKOJNË VËMENDJEN E KUVENDIT TË SHQIPËRISË.

Nisur nga rëndësia, por edhe koherenca, kërkojmë vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë për ndjekjen e disa rekomandimeve:

a. Mbi domosdoshmërinë e hartimit të ligjit “*Për përgjegjësinë materiale*”.

KLSH me një angazhim të vazhdueshëm konstruktiv dhe kontribut maksimal në luftën kundër korrupsionit, e konsideron të domosdoshëm hartimin e një ligji që të trajtojë në mënyrë të plotë rastet e përgjegjësiave materiale të të punësuarve në sektorin publik, me qëllim parandalimin e dukurive që nxisin dëmtimin e fondeve dhe asetëve publike, kjo e shprehur në rekomandimin e adresuar Kuvendit në Raportin paraqitur “*Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013*” për hartimin e Ligjit “*Për përgjegjësinë materiale*”. Krahas sa më sipër me praktika shkresore të veçanta (Nr. 659, Prot, datë 06.07.2015 dhe shkresën nr. 549/9, dt. 19.10.2015) dhe ky rekomandim i është adresuar Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kryetarit të Komisionit për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend dhe Ministrit të Financave.

Nga auditimet e kryera, KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë shpenzimin e tyre pa kriter dhe efikasitet, ose edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keq menaxhimi financiar.

Jemi përpjekur të përcaktojmë përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto keqpërdorime të fondeve publike, duke propozuar masa në formën e sanksioneve, kundrejt parregullsive financiare të shkaktuara prej tyre dhe të konstatuara.

Theksojmë se vlerësimi dhe matja e dëmit dhe adresimi i përgjegjësisë materiale kërkon procedura me konkrete, të detajuara.

Përgjegjësia e përbashkët shfaqet edhe në formën e përgjegjësisë për vendimmarrjen publike. Një vendimmarrje e gabuar, rrjedhojë e një organi kolegjal (*bord drejtues, këshill mbikëqyrës, komitet, etj*), mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në menaxhimin e fondeve publike. Praktika na ka mësuar me shumë raste kur vendimmarrjet kolegjiale kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në fondet shtetërore, por nuk kemi një rast të vetëm, kur shumat e humbura të jenë rikuperuar, si rrjedhojë e zhdëmtimit nga personat që kanë përgjegjësi materiale. Duhet theksuar se rol në vendimmarrjet kolegjiale nuk kanë vetëm anëtarët e forumit përkatës (*bord, këshill, etj.*) por edhe punonjësit që përgatisin vendimmarrjet, duke marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes. Ata nuk mund të lihen jashtë përgjegjësisë materiale solidare. Përgjegjësia materiale publike mund të jetë e plotë dhe e pjesshme. Pavarësisht përgjegjësisë së plotë të punëmarrësit (një nëpunës shtetëror), shumat e shpërblimit të dëmit ndaj fondit ose asetit Përgjegjësia materiale mund të jetë e drejtpërdrejtë ose indirekte. Kështu, për dëmet e shkaktuara nga punëmarrësi, i cili ka përgjegjësi direkte, menaxherët e niveleve më të larta (*shefi i sektorit, i drejtorisë e deri tek titullari i institucionit*) mund të kenë përgjegjësi indirekte, për shkak se nuk i kanë ushtruar si duhet funksionet e mbikëqyrjes dhe kontrollit ndaj vartësipërgjegjës i drejtpërdrejtë i shkaktimit të dëmit. Përgjegjësia indirekte e niveleve më të larta të menaxhimit shfaqet edhe në rastet kur dëmi nuk është vetëm monetar por lidhet me ndryshimin e destinacionit të burimeve publike, shkeljen e disiplinës financiare dhe buxhetore etj.

Objekt i këtij ligji duhet të jetë caktimi i shpërblimit të dëmit, sipas pjesëmarrjes dhe rolit të nëpunësit publik në shkaktimin e dëmeve. Ligji duhet gjithashtu të sigurojë një proces të qartë e transparent të shpërblimit të dëmit ndaj interesat publike, duke vendosur edhe një balancë mes mundësive reale të punonjësit zhdëmtues dhe duke ruajtur minimumin jetik. Ai duhet të sanksionojë përgjegjësinë materiale të titullarëve të subjekteve publike për vendimmarrjet e

gabuar në dëm të interesave publike. Ligji duhet të përcaktojë po ashtu edhe kriteret se kur përgjegjësia materiale shndërrohet në përgjegjësi penale. Për sa analizuar Për sa më sipër **kemi rekomanduar**:

Ngritjen e një grupi pune me specialist dhe përfaqësues të legjislativit, që do të vlerësojë dhe punojë për hartimin e Ligjit “*Mbi përgjegjësinë materiale*” në të cilën të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (*zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve*) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

b. Lidhur me iniciativën ligjore për hartimin e një Ligji “*Për Financimin dhe Auditimin e Subjekteve Politike*”, nga ana e **KQZ-së**, me qëllim të krijimit të një kuadri rregullator të mënyrës, kushteve të financimit, administrimit, mbikëqyrjes, transparencës dhe raportimit të përdorimit të pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike sipas praktikave më të mira që rregullojnë këtë fushë. Theksojmë nevojën për hartimin e një kuadri të plotë rregullativ që do të mundësojë krijimin e kontabilitetit të brendshëm të partive, raportimin e standartizuar të partive tek autoritetet mbikëqyrëse, kuptueshmëri të raporteve financiare, intensitet dhe besueshmëri të raportimit financiar, si dhe aktivitetet monitorues nga shoqëria civile dhe qytetarët, kjo do të garantonte transparencën në financimin e partive dhe uljen e shkallës së risqeve të korrupsionit në sistemin e financimit politik.”

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimit, KLSH konstatoi se, administrata e KQZ-së ka përgatitur një paketë sugjerimesh për përmirësime të nevojshme të kuadrit ligjor zgjedhor, të materializuara në dispozita të reja ligjore (17 rekomandime), të cilat ia ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, me shkresën nr. 2191, datë 03.05.2016.

c. Ndërkohë kërkojmë vëmendjen maksimale për ndjekjen e rekomandimit të KLSH-së, për **Avokatin e Shtetit**, me qëllim që: “Avokatura e Shtetit, bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit 16 të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “*Për Avokaturën e Shtetit*”, t’i drejtohet MZHETS-it për dërgimin e një kërkesë zyrtare dhe vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, në lidhje me iniciimin dhe ndjekjen me prioritet absolut nga ana e saj, të çështjes së arkëtimit të garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “...”, në procedurat e privatizimit të shoqërisë “...” në vlerën 85 milion Euro. Theksojmë se bashkëpunimi ndër-institucional midis Avokaturës së Shtetit dhe MZHETS duhet të jetë i vazhdueshëm, deri në arkëtimin e vlerës prej 85 milionë euro në buxhet”.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve, KLSH konstatoi se, Avokatit të Shtetit e ka limituar aktivitetin e vetë, lidhur me çështjen e mësipërme, vetëm në korrespondenca shkresore, pa ndërmarrë veprime të mëtejshme për realizimin e këtij rekomandimit.

Nga Kuvendi i Shqipërisë kërkohet të përdorë mekanizmat e tij, për të siguruar që nga ana e Avokatit të Shtetit dhe Ministrive përkatëse, të merren të gjitha masat e rekomanduara, deri në arkëtimin e vlerës prej 85 milionë euro në buxhet”.

25. DISA REKOMANDIME, QË KËRKOJNË VËMENDJEN E KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË.

Nisur nga rëndësia, por edhe koherenca, kërkojmë vëmendjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit të Shqipërisë, për ndjekjen e këtyre rekomandimeve:

a. Nisur nga problematika të hasura në procesin e programimit të investimeve në infrastrukturën rrugore për **Autoritetin Rrugor Shqiptar**, e gjujkojmë të nevojshëm hartimin e një strategjie afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të infrastrukturës (rrjetit) rrugore, duke u fokusuar në përmbylljen e të gjithë projekteve, të cilat janë të papërfunduara dhe më pas duke kaluar në hapjen e projekteve të reja. Investimet në fushën rrugore duhet të jenë të harmonizuara dhe në çdo rast në përputhje me strategjinë kombëtare dhe projektbuxhetet

afatmesme të miratuara, vetëm kështu do të mund të arrihet forcimi i kontrollit buxhetor aq i rëndësishëm për financat publike.

b. Nisur nga rëndësia e çështjeve të trajtuara, kërkojmë vëmendjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit të Shqipërisë, për ndjekjen e rekomandimeve, për të mundësuar që nga ana e **Ministrit të Financave**:

- të inicohet një mision verifikimi, për saktësimin e detyrimeve të klasifikuara dhe të raportuara si detyrime të prapambetura, (në çdo rast të evidentimit të niveleve të larta të këtyre borxheve), shoqëruar me masa konkrete për të përcaktuar shumën e detyrimeve që do të përfitojnë nga strategjia e hartuar nga Qeveria Shqiptare në mënyrë të saktë, transparente, të besueshme dhe të përcaktohet gjurma e auditimit. E vlerësojmë të domosdoshme që procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të fillojë vetëm pasi të jetë saktësuar lista e detyrimeve që do të përfitojnë nga fondet nën Strategjinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, listë që nuk mund të ketë shtesa dhe ndërhyrje si ato të konstatuara deri në këtë proces auditimi;

- të merren masa që fondet e huamarrjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të paraqiten me saktësi sipas kërkesave të ligjit të buxhetit.

- të realizohet një ndërhyrje e studiuar dhe e menjëhershme, në mënyrë që të përcaktohet në mënyrë eksplicite lloji i detyrimeve që mund të mbulohen, nisur nga konteksti i një borxhi të shëndetshëm duke pasur në vëmendje efektet në rritje në borxhin publik dhe në zhvillimet makro të kësaj strategjie, shoqëruar edhe me indikatorë që do të mundësonin ndjekjen e nivelit të detyrimeve të prapambetura në vijimësi pavarësisht nëse hyjnë në strategjinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura apo jo.

- të monitorohet respektimi në mënyrë strikte i radhës së shlyerjes së detyrimeve për secilën kategori të detyrimeve të papaguara, duke ndjekur parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar sipas sektorëve, nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga institucionet përkatëse etj, pasi nuk mund të ketë më justifikim, verifikimi i detyrimeve që përfitojnë nga kjo strategji (FIFO).”

III. TË TJERA

1. Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “k”, KLSH për mos zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara do tu drejtohet:

- Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar të ketë në vëmendje rekomandimet tona të cilësuar në pikën 24;

-Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar edhe ndihmën e tij për të sensibilizuar institucionet për rëndësinë e rekomandimeve në rritjen e përgjegjshmërisë në administrimin e fondeve publike dhe veçanërisht rekomandimet e cilësuar në pikën 25; si edhe

- Kryeministrit të Shqipërisë, për miratimin e një vendimi apo urdhri në lidhje me dhënien e një vlere detyruese, zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, dhe veçanërisht rekomandimeve të cilësuar në pikën 23.

2. Rekomandimet që rezultojnë të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për 3-mujorin e IV të vitit 2015 dhe 9-mujorin e vitit 2016”, do të përcillen në subjekte brenda muajit janar 2017.

3. Ky auditim është vlerësuar i dobët nga Kryetarit i KLSH-së. Nisur nga sa më sipër për të vlerësuar punën e audituesve dhe në mënyrë që të saktësohet shkalla e zbatimit të rekomandimeve, subjektet e përcaktuara sipas programit të auditimit do të riauditohen nga KLSH-ja, në përputhje dhe në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.